



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr.12, datë 05. 04. 2012

PËR

“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 71, DATË 20.12.2005, “PËR KALIMIN KAPITAL TË ASETIT “PJESË E OBJEKTIT” TË NDËRMARRJES TË SHËRBIMEVE MEKANIKE, RRUGA “SABAUDIN GABRANI” BASHKISË TIRANË SI DHE NDRYSHIMIN E DESTINACIONIT TË KËTIJ OBJEKTI NË QENDËR SOCIALE “TË QËNDROJMË SË BASHKU””.

Në mbështetje të nenit 8/II, nenit 10, pika 3/II/C, nenit 11, pika 3/c të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për ‘Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore’; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 03.04.1993 për “Kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore” (i ndryshuar); pikës 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.626, datë 21.09.2004 për “Miratimin e listës së inventarit dhe transferimin në pronësi të Bashkive dhe Komunave të disa pronave të paluajtshme shtetërore që do të transferohen për ngritjen e qendrave sociale” si dhe të shkresës nr.39, datë 21.03.2012, të ndërmarrjes Metalike “Tirana”, Bashkia e Tiranë propozon pranë Këshillit Bashkiak për kalimin kapital të asetit “pjesë e objektit” të Ndërmarrjes Metalike “Tirana”, Rruga “Sabaudin Gabrani” Bashkisë Tiranës si dhe përcaktimin e destinacionit të asetit për qendër sociale”.

V E N D O S I:

1. Kalimin kapital të asetit, pjesës së objektit të Ndërmarrjes Metalike “Tirana” në Rrugën “Sabaudin Gabrani”, nga Ndërmarrja Metalike “Tirana” në aparatën e Bashkisë së Tiranës me qëllim shfrytëzimin e tij për qendër sociale.
 - Objekti në Rrugën “Sabaudin Gabrani”.
 - Sipërfaqja totale 1994 m², nga të cilat 1039.4 m² sipërfaqe nën objekt.
 - Vlera kontabël 3 865 403 lekë.
2. Në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi të kryhet ndryshimi i destinacionit të këtij objekti në qendër sociale si dhe të kryhen veprimet përkatëse për reflektimin e vlerave kontabël sipas ligjit për “Kontabilitetin”, nga Ndërmarrja Metalike “Tirana”, pranë aparatit të Bashkisë Tiranë.
3. Ngarkohet Ndërmarrja Metalike “Tirana”, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve dhe Drejtoria e Financës, për zbatim e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI